



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MONITORIMIT TË PROCEDURAVE

Nr. 1038/10 Prot.

Tiranë, më 17.06.2022

Të dhëna mbi Vendimin

Nr. 57, datë 17/06 2022

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 78/1/b të Ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik" në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik "Oni Trade", shpk, nga e drejta për të fituar kontrata publike, për mospërbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratën me objekt: "*Publikime dhe materiale promovuese*", me vlerë 279.999 lekë (me TVSH), të nënshkruar nga Qendra Kulturore Tirana (në vijim "AK").

APP i ushtron detyrat dhe kompetencat e saj në bazë dhe për zbatim të nenit 23 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin Publik".

Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit NIPT, adresa): "Oni Trade" Shpk, me NIPT L21410012I, me adresë: Rruga "Hysen Haxhi Dalli", Dyqani Nr. 4, Njësia Nr. 9, Tiranë.

I. Arsytet e fillimit të procedimit administrativ:

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik "Oni Trade" shpk, ka nisur për mospërbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratën Nr. 772 Prot., datë 07.12.2021 me objekt: "*Publikime dhe materiale promovuese*", me vlerë 279.999 lekë (me TVSH), nënshkruar me AK.

II. Gjetjet:

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se ndodheshim në kushtet e mospërbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas parashikimeve të nenit 78/1/b të LPP, në të cilin përcaktohet se: "*1. Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike për një periudhë nga 3 muaj deri në 3 vjet për: b) mospërbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike, që kanë ndodhur për faj të operatorit ekonomik*".

III. Masat:

Me Vendimin Nr. 57, datë 17.06.2022, APP ka vendosur të përjashtojë për 3 (tre) muaj operatorin ekonomik "Oni Trade" Shpk, me NIPT L21410012I, nga e drejta për të fituar kontrata publike, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.